



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 548, datë 01.10.2024**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN PËR EMËRIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË  
Z. {...} PËR POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË NJËSITË E SHËRBIMIT  
LIGJOR PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 01.10.2024, mbështetur në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në 86, shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, të përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e tij;

**V Ë R E N**

**I. MBI FAKTET E PROCESIT TË KUALIFIKIMIT DHE VIJIMIT TË  
PROCEDURËS SË EMËRIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË Z. {...}**

1. Me vendimin nr. 157, datë 04.04.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli) konstatoi se z. {...} plotësonte kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, profili ndihmës ligjor. Ky verifikim u krye bazuar në nenet 34 pika 6, 53 pika 4, 55 dhe 56, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim si “Ligji për Pushtetin Gjyqësor”).
2. Me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, mbështetur në nenin 53, të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”, si dhe në Vendimin e tij nr. 424/2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve

*dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli, ka filluar procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2023 - 2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat.*

3. Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli me vendimin nr. 469, datë 31.07.2024 ka vendosur kualifikimin e kandidates fituese z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.
4. Z. {...} ka ndjekur programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor viti akademik 2023-2027 në Shkollën e Magjistraturës. Me Vendimin nr. 29, datë 03.07.2024, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, Shkolla e Magjistraturës e rendit të gjashtin në listën e kandidatëve, me 77.30 pikë.

Në vijim të procedurës, Këshilli, për shkak të ndryshimit të përbërjes së Komisioneve të Përhershme, me vendimin e tij nr. 486, datë 13.09.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, në vijim me Vendimin nr. 521, datë 24.09.2024, ka vendosur :

*Caktimin e znj. Yllka Rupa relatore të procedurave të kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Fatmira Luli, si më poshtë :*

*... ii. Z. {...}*

5. Më datë 26.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit 424/2020, z. {...} në rrugë elektronike, u njoftua për caktimin e relatorit të ri të kësaj procedure si dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

## **II. VLERËSIME MBI VERIFIKIMIN E KUSHTIT FORMAL TË PRANIMIT NË SHRBIMIN CIVIL PËR Z. {...}**

6. Për z. {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, të përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kriteret të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:
  - a) *Të jetë shtetas shqiptar* - Për këtë kriter, në dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 17.05.2019, pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për lënien ose heqjen e shtetësisë shqiptare për subjektin pas këtij momenti;

- b) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar* - Për këtë kriter, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) *Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur* - Zotërimi i gjuhës shqipe të folur dhe të shkruar prezumohet për çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar arsimin e detyrueshëm;
- d) *Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse* - Subjekti rezultoi se është në kushte shëndetësore të cilat e lejojnë të kryejë detyrën pasi, sipas raportit mjeko-ligjor të datës 06.02.2023, lëshuar nga Qendra Shëndetsore nr. 3, Shkodër, ka rezultuar “I aftë për punë” dhe nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme për cenimin e kësaj aftësie;
- e) *Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje* - Sipas informacionit të përpunuar nga Struktura e Posaçme pranë KLGJ<sup>1</sup>, referuar dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultoi se z. {...} nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Gjithashtu, nga të dhënat e dosjes personale dhe tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme që të cenojnë përmbushjen këtij kriteri;
- f) *Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.* - Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga z. {...} në jetëshkrimin (CV) e tij, në vërtetimin (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore për Individin - E-SIG 03/a, me nr. T07725197, datë 05.02.2023 dhe Vërtetim për Bazën e Vlerësuar, e datës 05.02.2023) si dhe në shënimet në librezën e punës të depozituar në dosjen e tij të aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Entit Kombëtar të Banesave si drejtor nga data 02.03.2006 deri në datë 31.01.2014, që është larguar me dëshirën e tij dhe më pas nga data 01.04.2014 dhe në vazhdim si avokat. Nga shkresa me nr. 42 prot., datë 06.02.2023, e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, e depozituar në dosjen e tij të aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, rezultoi se z. {...} nuk ka detyrime financiare dhe në ngarkim të tij nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces.

### III. KONKLUZIONI

7. Në gjithë sa më sipër, duke konstatuar se z. {...}:
- plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë këshilltar ligjor;
  - ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, e ka renditur në listën e kandidatëve fitues, duke e klasifikuar të gjashtin me 77.30 pikë;
  - është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 469, datë 31.07.2024, “Për kualifikimin e kandidatës

<sup>1</sup>Shkresa me nr. 2781/4 prot., datë 12.04.2021, e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, z. {...}*”,

Këshilli vlerëson t’a kualifikojë për emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, në nenet 36, 42 dhe 59, të ligjit nr. 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor*”, si dhe në Vendimin e tij nr. 469, datë 31.07.2024, “*Për kualifikimin e kandidatës fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, z. {...}*”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**